

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 11¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24) dhe neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 11 të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1 datë 29.07.2019, dhe në lidhje me nenin 3 paragrafi (14) të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 87/25), Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 23-të mbajtur më 05.06.2025, miratoi:

RREGULLORE
PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E APLIKIMIT PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E BOTUESVE TË
MEDIAVE ONLINE – INTERNET PORTALEVE DHE PËR MËNYRËN E UDHËHEQJES SË REGJISTRIT TË
BOTUESVE TË MEDIAVE ONLINE – INTERNET PORTALEVE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore rregullohet forma dhe përmbajtja e aplikimit për regjistrim në Regjistrin e botuesve të mediave online – internet portaleve (në tekstin e mëtejme Regjistri), të cilën botuesit e mediave online – internet portaleve e dorëzojnë në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (në tekstin e mëtejme Agjencia) dhe mënyrën se si Agjencia e udhëheq Regjistrin.

II. REGJISTRIMI

Neni 2

Botuesi i medias online-internet portalit drejtuar Agjencisë dorëzon Aplikim për regjistrim në Regjistër, në formular të posaçëm të përcaktuar nga Agjencia (pjesë përbërëse e Rregullores si Shtojcë nr. 1).

Neni 3

(1) Aplikacioni përmban:

1. Të dhëna për botuesin e medias online-internet portalit:
 - emri i plotë i botuesit të medias online-internet portalit;
 - numri amëz i subjektit;
 - selia e botuesit të medias online-internet portalit;

¹ Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 248/18).

- emri dhe mbiemri, adresa dhe NVAQ e administratorit;
- telefoni dhe adresa elektronike e botuesit të medias online-internet portalit; dhe
- emri dhe mbiemri, NVAQ dhe adresa e pronarit (nëse është person fizik) / emri i plotë i subjektit, NVAS dhe selia e pronarit (nëse është person juridik).

2. Të dhënat për median online-internet portalit:

- emri i medias online-internet portalit;
- adresa në internet e medias online – internet portalit;
- adresa e redaksisë;
- emri dhe mbiemri, adresa dhe NVAQ e kryeredaktorit;
- regjistrues i internet domenit;
- telefoni dhe adresa elektronike të medias online-internet portalit; dhe
- përshkrim të medias online-internet portalit (nëse bëhet fjalë për media online-portal interneti me fushëveprim të vogël dhe/ose të specializuar).

- (2) Botuesit e mediave online – internet portaleve me fushëveprim të vogël dhe/ose të specializuar, së bashku me Aplikimin detyrimisht duhet të paraqesin kontratë pune lidhur me person të angazhuar (në origjinal ose kopje të noterizuar).
- (3) Agjencia do t'i shfrytëzon të dhënat personale të paraqitura vetëm për qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe në përputhje me rregulloren ligjore nga fusha për mbrojtjen e të dhënave personale.
- (4) Botuesi i medias online-internet portalit është i detyruar të njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave në afat prej shtatë ditësh nga ndodhja e ndryshimit.

Neni 4

- (1) Regjistri i botuesve të mediave online-internet portaleve udhëhiqet në formë elektronike dhe përmban të dhëna për:
- firmën dhe selin, përkatësisht emri dhe adresa e botuesit të medias online – internet portalit
 - emri dhe mbiemri i personit përgjegjës të botuesit të medias online – internet portalit;
 - emri i medias online – internet portalit;
 - adresë interneti e medias online – internet portalit dhe
 - regjistruesi i domenit të internetit të maqedonasë. mk ose.mkd.

Neni 5

- (1) Për t'u regjistruar në Regjistër, botuesi i medias online-internet portalit duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:
- të ketë të regjistruar veprimtarin në Regjistrin Qendror të RMV-së;
 - të ketë seli dhe redaksi në RMV-së;
 - në emrin e tij të ketë të regjistruar domen interneti të maqedonasë. mk ose.mkd; dhe
 - të përmbushë kushtet minimale kadrovike të përcaktuara në nenin 5, paragrafët 11 dhe 12 të Ligjit për Media.

- (2) Në afat prej tre ditë pune nga dita e dorëzimit të aplikimit të plotë dhe të rregullt nga botuesi i medias online-internet portalit, Agjencia duhet të paraqesë kërkesë në Regjistrin Qendror të RMV-së për dorëzimin e statusit aktual të botuesit të medias online-internet portalit dhe në Agjencinë e Punësimit për dorëzimin e të dhënave për numrin e të punësuarve me orar të plotë pune në botuesin e medias online-internet portalit.
- (3) Agjencia duhet ta regjistrojë botuesin e medias-internet portalin në Regjistër në afat prej tre ditësh nga dita e kompletimit të dokumentacionit, nëse konstaton se i plotëson kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit për Media.

III. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 6

Botuesit ekzistues të mediave online – internet portaleve që gjatë periudhës së krijimit të Regjistrit, kanë kod kryesor të të ardhurave të ndryshëm nga veprimtaria e publikimit të përmbajtjeve informuese, edukative dhe argëtuese në formën e tekstit, audio ose formati audiovizual përmes medias online – internet portalit, do të regjistrohen në Regjistër në bazë të klauzulës së përgjithshme të biznesit të regjistruar, deri më 31 mars 2026.

Pas skadimit të këtij afati, Agjencia do të fshijë nga Regjistri të gjithë botuesit e mediave online – internet portaleve, ku kodi kryesor i të ardhurave nuk do të jetë publikimi i përmbajtjeve informuese, edukative dhe argëtuese në formën e tekstit, audio ose formati audiovizual përmes një media online – internet portali (botimi i gazetave, ose revistave dhe publikimeve periodike në formë dixhitale).

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën pas publikimit të saj në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit, d.v.**

Lazo PETRUSHEVSKI



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

**AGJENCIA PËR SHËRBIME
MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**

**Pallati Panko Brashnarov
rr. "Makedonija" nr.38 , 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
Tel: +389 23 103 400
Faks: +389 23 103 401
e-mail: contact@avmu.mk**

(vula pranuese e ASHMA-së)

**APLIKIM PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN
E BOTUESVE TË MEDIAVE ONLINE – INTERNET PORTALEVE**

1. Të dhëna për median online-internet portalit

Emri	
Adresa e internetit	
Adresa e redaksisë	
Kryeredaktori	
emri dhe mbiemri	
Adresë	
NVAQ	
Regjistruesi i internet domenit/organizatës/emri	
Kontakt	
Telefon	
Adresa elektronike	
Përshkrimi i medias online (plotësohet vetëm nëse bëhet fjalë për media online – internet portal me fushëveprim të vogël dhe/ose të specializuar)	

2. Të dhëna për botuesin e medias online-internet portalit

Emri i plotë	
Selia	
NVAS	
Personi përgjegjës/administrator	
Emri dhe mbiemri	
Adresë	
NVAQ	
Kontakt	
Telefon	
Adresa elektronike	
Pronar	
emri dhe mbiemri/emri i plotë	
Adresë/selia	
NVAQ/NVAS	
(nëse ka më shumë pronarë, përsëritni këto fusha për secilin prej tyre)	

Vula dhe nënshkrimi i personit përgjegjës

Shtojca e aplikimit – Kontratë(a) e punës të lidhur/a me personin/(a) të angazhuar (në origjinal ose kopje të noterizuar)²

²Vlen vetëm për botuesit e mediave online – internet portaleve me fushëveprim të vogël dhe/ose të specializuar.